

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje autobetornjere (Kamion per perzierje dhe transport betorni)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 42641300-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,580,500 (kater milion e pesqind e tetedhjet mijë e peqind) , pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Memaliaj, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore duke filluar nga data e zhvillimit të tenderit lëshuar nga autoriteti përkatës, **ku vlera mesatare e vjetore për tre vitet e fundit ushtrimor duke filluar nga data e tenderit të jet sa vlera e fondit limit që prokurohet .**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar

2.2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për 3 tre vitet e fundit ushtrimor duke filluar nga data e zhvillimit të tenderit **ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, nenin 55, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten

2.3.Kapaciteti Teknik.

2.3.1 Furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se **40 %** fondit limit, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës:

- Kur furnizimet jane realizuar me entet publike duhet të paraqitet kontrata e ngjashme me entin që ka realizuar këtë lloj furnizime shoqëruar me vërtetimin e realizimit me sukses nga autoriteti kontraktor.
- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara e firmosur dhe vulosur nga palët.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Duke qene se kjo procedure prokurimi do te konkludoje me nje kontrate sherbim per te deshmuar pervojen e meparshme vlere totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

• Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

- 1.1.1 Mjeti duhet te jet i paperdorur dhe operatori ekonomik fitues duhet te plotesoi deklaraten e garancis per 1 nje vite ku te perfshihen sherbimet qe kerkohen gjat perdorimit 1 vjecar
- 1.1.2 Operatori ekonomik duhet te paraqes dokumentat doganore qe vertetojne shlyerjen e faturave doganore ne menyre qe mjeti te jet gati per rregjistrim .
- 1.1.3 Operatori ekonomik duhet te paraqes skeden teknike si dhe fotot te mjetit ku te jen qartsishte te dukshme specifikimet teknike
- 1.1.4 Operatori ekonomik dhet te paraqes foto te qarta te mjetit per tu verifikuar nga komisioni i vlersimit te ofertave
- 1.1.5 Operatori ekonomik duhet te paraqes deklaraten ku garanton kryerjen e sherbimeve gjat peridhes se garancis 1 vjecare per defekte qe nuk shkaktohen nga Autoriteti kontraktor .
- 1.1.6 Sqarojme se OE i shpallur fitues ka 5 (pese) dite koh nga njoftimi i fituesit per te sjell mallin prane autoritetit kontraktor per tu kontrolluar fizikisht nga komisioni i marjes ne dorzim nese eshte a jo sipas specifikimeve teknike te kerkuara ne dst neso jo ne rast se mjeti nuk eshte sipas specifikimeve teknike te kerkuar ne dst perperben shkak per skualifikim .

1. Operatori ekonomik ofertues duhet te ketw ne pronesi ose me kontrat qeraje nje mjet transporti rimokjator jo me pak se 25 ton 1 cope

- Per mjetin ne perputhje me kodin rrugor te paraqiten certifikata e pronesis si dhe dokumentacionin perkates siguracion, leja e qarkullimit, aktin e kolaudit te mjetit ne

dispozicion, certifikat per transport mallrashe, lejet e drejtimit si dhe libreza shendetsore te drejtuesit te mjetit

- ***Per mjetin e siguruar me qera kontraten perkatese noteriale e furnizimit e vlefshem per te gjithë peridhen e realizimit te kontrates document qe verteton rregjistrimin e mjetit certifikat e kontrollit Teknik siguracion te mjetit te vlershem taksat vjetore si dhe certifikaten e transportit te mallrave***

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kriteret e vlerësimit: Është çmimi më i ulët i ofruar.

Afatet e ekzekutimit 5(pese) dit nga lidhja e kontrates

Komisioni unanimisht bëri miratimin e tyre dhe u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave, në Sistemin Elektronik.

NJESIA E PROKURIMIT